

THE APPROACH ON TEACHING WRITING A CREATION-ESSAY

Merita Banjica

Faculty of Languages, Cultures and Communication SEEU, Tetovo, N. Macedonia,
meritabanjica@yahoo.com

Abstract: The theoretical scientific treatment of this paper is based on the principle of coherence between the didactic theoretical aspect of teaching the process of writing a creation, the theoretical psychological aspect of the individual to activate memory, the constructivism aspect to activate learning, the aspect of language culture, while the empirical experimental aspect is done on the basis of the practical application of the teaching process of writing a creation according to the professional mastery of teaching (my experience), which from practice is transformed into interdisciplinary scientific theory.

The creative skills of the 21st century individual are presented as a necessary need for every individual to reflect creative skills in any job to challenge in the labor market competition in the "Knowledge Society". This urgent need obliges all language teachers to teach elementary school students how to use writing methods and techniques. The process of writing creation requires the activation of the processes of critical thinking, problem thinking, and creative thinking reflected in a unique writing framework or whole, creation.

The purpose of this paper is to reflect the teaching strategy for creating a creation by students by acquiring knowledge of the writing process, applying procedures and developing creative mastery skills. This goal is based on two objectives:

- In the first part to provide theoretical explanations for the process of writing creations.
- The second part provides a teaching strategy for writing an essay from my experience as a teacher implemented with 8th graders in elementary school.

Keywords: creation, memory, perception, teaching strategy.

QASJA NË MËSIMDHËNIEN E TË SHKRUARIT TË NJË KRIJIMI-ESE

Merita Banjica

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, SEEU, Tetovë, N. Maqedoni,
meritabanjica@yahoo.com

Abstrakt: Trajtimi teorik shkencor i këtij punimi bëhet mbi parimin e koherencës midis aspektit teorik didaktik të mësimdhënies për procesin e të shkruarit të një krijimi, aspektit teorik psikologjik të individit për aktivizimin e kujtesës, aspektit të konstruktivizmit për aktivizimin e të nxënësit, aspektit të kulturës së gjuhës, ndërsa aspekti empirik eksperimental bëhet në bazë të zbatimit në praktikë të mësimdhënies i procesit së të shkruarit të një krijimi sipas mjeshtrisë profesionale të mësimdhënies (përvojës sime), që nga praktika shderrohet në teori shkencore interdisciplinare.

Aftësitë krijuese të individit të shekullit XXI paraqiten si nevojë e domosdoshme për çdo individ për të reflektuar shkathtësi krijuese në çdo punë për të sfiduar në konkurrencën e tregut të të punës në "Shoqërinë e Dijes". Kjo nevojë e domosdoshme aktuale i obligon të gjithë mësimdhënësit e gjuhëve, që nxënësit prej në shkollë fillore t'i mësojnë si t'i përdorin metodat dhe teknikat e të shkruarit. Procesi i të shkruarit të krijimit kërkon aktivizimin e proceseve së të menduarit kritik, të menduarit problemor dhe të menduarit krijues të pasqyruara në kornizë ose tërësi unike, krijim.

Qëllimi i këtij punimi është reflektimi i strategjisë së mësimdhënies për të krijuarit e një krijimi nga nxënësit me përvetësimin e njohurive për procesin e të shkruarit, zbatimin e procedurave dhe zhvillimin e shkathtësive së mjeshtrisë të krijimtarisë. Ky qëllim mbështetet në disa dy objektiva:

- Në pjesën e parë të ofrohen sqarime teorike për procesin e të shkruarit të krijimeve.
- Në pjesën e dytë ofrohet një strategji e mësimdhënies për të shkruarit e një eseje nga përvoja ime si mësimdhënëse e zbatuar me nxënësit të klasave të VIII në shkollë fillore.

Fjalët kyçe: krijim, kujtesë, perceptim, strategji e mësimdhënies.

1. HYRJA

Në pjesën e parë të këtij punimi ofrohen sqarime teorike për konceptet kyçe. Krijim do të thohë të gjenorosh diçka të re duke përdorur njohuritë e qëndrueshme në memorie dhe ngacmimet e jashtme psikologjike për të bërë në një tërësi unike me aktivizimin e të menduarit kritik, të menduarit krijues për të bërë zgjidhjen e problemit të parashtruar. Arsimi i shekullit XXI ka qëllim t'i zhvilloj njerëzit aftësi mendore krijuese dhe shkathtësi krijuese, prandaj edhe kërkon nxënësit ta kultivojnë krijimtarinë se aktualisht në çdo veprimtari më së tepërmi kërkohen individ me mendime krijuese.

Çdo individ prej momentit kur lind i ka të krijuara edhe aftësitë krijuese të tij, por ata duhet në vazhdimësi duhet t'i mësojë, t'i zgjerojë përmes aktivitetit të punës për të arritur shkathtësitë krijuese të gjenerimit të krijimeve me vlerë individuale dhe shoqërore. Përdorimi i strategjisë së të shkruarit, u ndihmon nxënësve t'i përvetësojnë rregullat e të shkruarit për të krijuar krijim-ese pragmatik, që të jetë i kuptueshëm për dëgjuesit dhe lexuesit e tij. Prezantimi i çdo krijimi nga një krijues para një auditori merr edhe vlerë shoqërore.

Në pjesën e dytë ofrohet metodologjia e hulumtimit dhe ofrohet strategji e mësimdhënies nga përvoja ime, ku bëhet shndërrimi i përvojës së mësimdhënies i realizuar me platformën classroom. google dhe zoom.us në teori didaktike. Kjo strategji kalon nëpër disa hapa, ku përdoren metoda dhe teknika mësimore të ndryshme. Në pjesën fundit ofrohen përfundimet e nxjerra nga studim shkencor me vlerë interdisciplinare. Çdo nxënës mund të bëhet edhe shkrimtar i mirë, prandaj duhet të mësohet të shkruaj diçka të re dhe interesante për lexuesit e vet.

2. SQARIMI I KONCEPTIT KRIJIM

Krijimi me shkrim është paraqitje faktike e kompetencave individuale kognitive, afektive dhe psikomotorë lidhur me një çështje të caktuar. Krijimi është ide origjinale, arritje e sintezës së të menduarit kritik dhe dhe të menduarit krijues, për të gjeneruar ide të reja duke bërë vetëvlerësimin e idesë, që e shkruan si ide me vlerë apo pa vlerë. Të menduarit krijues përdoret për të gjeneruar diçka të re duke e përdorur njohjet në kujtesë (mënyrë e re për të zgjidhur probleme, proces i ri për të arritur qëllim).

Në studimin e saj Doyle (2019) të menduarit krijues e definojnë si aftësi individuale për të siguruar vendin e punës si shkathtësi gjuhësore e nevojshme për t'i shprehur kompetencat të organizatës së veprimtarisë me prezantim të krijimit me shkrim. Doyle (2019) në studimin e saj thotë se të menduarit krijues i individit është shumë i rëndësishëm edhe për siguruar vendin e punës sidomos në veprimtaritë e biznesit dhe shkencës, ku kërkohen:

- Individ me aftësi krijuese për të bërë diçka të re me të menduarit krijues dhe të menduarit kritik të tyre, për t'i verifikuar e jo t'i pranuar çdo gjë, që ju jepet dhe të mos i përsërisin punët si ia kanë bërë të tjerët, por të jenë njerëz krijues, shpikës, zbulues dhe zgjidhës të problemeve në çdo veprimtari për të sjellur perspektiva të reja. p.sh një konflikt në mes punonjësve, një grup të dhënash, një projekt grupi, etj.
- Individ me aftësi bashkëvepruese në partneritet me punëdhënësin e ardhshëm, ku aftësitë e të menduarit krijues duhet të ndahen punëdhënësin e ardhshëm, mirëpo çdo krijues duhet të ketë njohje të krijimtarisë vetjake, që t'i reflektojë ato në aplikimet për punë, ku edhe shprehet shprehet aftësia e menduarit krijues.

Doyle (2019) bën dallim në mes krijimtarisë me detyra artistike siç është shkrimi i një romani, pikturimi i një fotografie ose kompozimi i muzikës dhe në mes krijimtarisë së biznesit dhe shkencës, ku veprojnë mendimtarët krijues, që nuk janë artistë, por punojnë për biznes dhe shkencë. Nxënësi prej në shkollë fillore pranon njohuri për të për të shkruarit, i zhvillon shkathtësitë e të shkruarit duke bërë krijime të ndryshme në stile të ndryshme si:

Tabela1. Llojet e krijimeve, stilet e të shkruarit dhe cilësitë e reflektuar në krijime

Krijimi	Stilet funksionale	Cilësia
Letër personale	Stili bisedues (komunikativ)	personale
Letër zyrtare (lutje, ankesë, kërkesë, njoftim, procesverbal)	Stili administrues	dokumentare
Reportazhë, udhëpërshkrim, memoar, ese	Stili publicistik	dokumentare
Ese shkencore, recenzim, libër, statij etj.	Stili shkencor	dokumentare
Tregim, këngë, novelë, roman, etj.	Stili letrar-artistik	artistike

Në të gjitha këto lloje të krijimeve përdoret eseja, prandaj nxënësve duhet t'u mësohet shkrimi i saj.

2.1. Të shkruarit e një krijimi kërkon aktivizimin e proceseve të menduarit

Koncepti "të menduarit" sipas psikologjisë Bihevoriste është rrjedhojë e veprimtarive të proceseve të padukshme, që ndodhin në trurin e njeriut, por mund t'i vëzhgojmë nëpërmjet veprimtarive së të sjellurit e tij si rrjedhojë e të menduarit të logjikshëm dhe të mirë. (Doyle, 2020; Zajazi, 2003). Të menduarit, sipas psiko-pedagogjisë për shkaqe praktike mësimore, klasifikohet në tre kategori, që vazhdimisht kanë ndikim te njëra-tjetra dhe ndihmohen në mes veti dhe nuk mund të funksionojnë njëra pa tjetrën:

- *Të menduarit kritik* ka karakter vlerësues, që mbështetet në njëkohësisht në analizë kritike të fakteve dhe të asryes logjike. Lidhet me të menduarit e besimit për pranim të njohurive dhe përzgjedhjes së njohurive të ofruara ose të mbajtura mend. Ky tip i të menduarit karakterizohet me pyetjet me përcaktimin e kriterit të pranimit ose besimit, që mbështet në analizën e fakteve dhe në arsyen logjike së të vepruarit (*çfarë njohurie të pranoj? ose çfarë njohurie të besoj? dhe cilën alternativë (njohuri) ta zgjedh? ose kur të veproj?*).
- *Të menduarit problemor* është proces i sistemuar analitik, në të cilin ndodh përdorimi i të njohurës për ta zgjidhur të panjohurën ka karakter të zgjidhjes së ndonjë çështjeje të pazgjidhur. Në këtë proces përdoret përvoja e mëparshme e përdorur për zgjidhjen e ndonjë problemi, që vihet në përdorim për të zgjidhur një problem të ri, fillojmë të mendojmë se si atë, që e dimë ta përdorim për ta njohur atë, që nuk e dimë.
- *Të menduarit krijues është proces i të menduarit, që përqendrohet në zhvillimin e zgjidhjeve të produkteve ose të proceseve origjinale duke i përdorur veglat krijuese ose aftësitë mendore krijuese. Krijimtaria nuk është privilegj individual, por është pjesë e "universit" të aftësive menduese të secilit individ. Të menduarit krijues është trajtim dievergjent dhe me imagjinatë i çështjes, që trajtohet. Intuita (parandjenja) është një burim shumë i rëndësishëm i dijes për prodhueshmërinë e kreacioneve (krijimeve). Këto janë cilësi, që e veçojnë të menduarit krijues nga të menduarit riprodhues ose rikrijues. (Zajazi, 2003).*

Të menduarit zhvillohet me aktivizimin e dijeve, aftësive dhe qëndrimeve.

- *Dijet* janë njohuritë e grumbulluara në mendjen e njeriut rreth një objekti të caktuar, që shfrytëzohen për zgjidhjen e çdo situatë sipas nevojës së rastit. Dijet krijohen me njohuri dhe përvojë pune.
- *Aftësitë* (proceset e të menduarit) janë mjete së të menduarit (proceset e veprimeve intelektuale), që aktivizohen në mbështetje të dijeve (njohuri të sistemuara në kujtesë sipas, rregullave, fakteve) me aktivizimin e aftësive së të menduarit.
- *Qëndrimet* reflektohen me disponimin e subjektit (personit) ndaj objektit për të perceptuar dhe për ta vënë në lidhje në mënyra të veçanta me mjedisin. Qëndrimet mund të jenë pozitive, negative dhe indiferente. Personi për të krijuar qëndrim pozitiv duhet të ketë njohuri për dobësitë e njohurive të ofruara, prandaj ai kërkon të bindet me arsyetime teorike.

3. KUJTESA

Kujtesa si sistem apo sisteme, që aktivizojnë trurin në proces për pranim të informatave të mësuar, regjistrimit të tyre, ruajtjes dhe të mbajturit mend me qëllim optimist për të vepruar në të ardhmen me rinjohjen e tyre për të gjeneruar diçka të re në përshtatshmëri me rastet e situatave të ndryshme. Sjellja njeriut ndryshon në vazhdimësi falë aftësive të kujtesës, aftësive së të mësuarit, përvojës dhe përjetimeve gjatë të mësuarit e tij. (Burton 2019; Nushi, 2002).

Aftësia e kujtesës dhe aftësia e të mësuarit të lëndëve të ndryshme, të lëvizjeve, të shprehive, të shkathtësive të dijeve, të gjithë përvojës së njeriut dhe përjetimeve janë të pandara. Kujtesa është faktor, ku gjen mbështetje ajo, që është mësuar në proces gjatë jetës së individit dhe të përdoret edhe në veprimtari të tjera. Të mësuarit e fiton *vlerën e faktorit zhvillues* të njeriut në bazë të kujtesës dhe proceseve të saj. Kujtesa është veti biologjike e qenieve të gjalla dhe jeta e tyre pa kujtesë do të ishte e pamundur, pa kujtesë nuk ka të mësuar.

Kujtesa, të mësuarit dhe harresa janë tri procese të ngushtëlidhura, që vihen në lidhje ndërmjet tyre dhe së bashku përbëjnë një kontinuitet procesesh të njëpasnjëshme dhe të pandara ndërmjet tyre. Të mësuarit shkakton ndryshime në strukturën nervore dhe në lidhjet ndërmjet tyre. Kujtesa është proces intelektual, por edhe aftësi e posaçme e individit për ruajtje, riprodhim dhe rinjohje e njohurive dhe ndryshimeve të tyre, kurse harresa është zbehje, humbje, zhdukje e këtyre ndryshimeve nervore dhe dobësim e humbje e lidhjeve të këtyre ndryshimeve. (Burton 2019).

Kujtesa dhe funksioni i saj vërehen në tri procese të saja:

- *Retecioni (të mbajturit mend)* fillon me mbajtjen mend të lëndës, që njeriu e mëson (përmbajtjeve), që e përcjell gjatë kontaktit të tij me objektet, me dukuritë dhe me proceset e ndryshme të realitetit.
- *Rikonjicioni (rinjohja)* ndodh kur individit e lexon(pranon) dhe percepton njohuri të njohura nga më parë, informatë jo e re.
- *Riprodhimi i asaj, që është mësuar ose përjetuar më parë dhe tani përfytyrohet.* Riprodhimi është ringallje gjurmësh nervore të përmbajtjeve fjalësore, perceptimesh dhe lëvizjesh të mësuar nga individit, që parafytyrohen.

1. Në bazë të kriterit të perceptimeve kur mbahen mend dallohen tri lloje të kujtesës:

- *Kujtesë sensorike* përbën fazën e parë të sistemit të kujtesës, ku informatat e caktura merren me anë të shqisave të individit, me shqisat e të pamurit, të dëgjuarit etj. në formë figurash mentale, që zënë vullum në kujtesë, por kohëzgjatje të shkurtër.

- *Kujtesa afatshkurtër* është faza e dytë e kujtesës, kur deportojnë vetëm disa prej figurave mentale të kujtesës shqipsore dhe ku krijohen kushte për dhënien e domethënies dhe bartjen e tyre në të ashtuquajturën "*depo e kujtesës afatgjate*". Kjo fazë zgjat afër dhjetë (10) sekonda dhe në kujtesë mund të qëndrojnë rreth shtatë elemente.
- *Kujtesa afatgjatë* është episodike (regjistron përvojë kuptimore) dhe semantike (regjistron fakte dhe koncepte abstrakte). Lëndët e kujtesës sensorike dhe ato të kujtesës afatshkurte mund të vendosen në "*depon e kujtesës afatgjate*" në bazë të përsëritjeve, që i bëhen asaj lënde.

2. Në bazë të kriterit të psikologjisë së përgjithshme dallohen: 1) *Kujtesë e qëllimshme*, kur individ i vë vetes detyrë ta mbaj në mend dhe ta riprodhojë përmbajtjen e asaj lënde dhe 2) *Kujtesë e paqëllimshme*, kur individ nuk i vë vetes qëllim për ta mbajtur mend informacionin, mirëpo rastësisht mbahet mend kumtimi i ndonjë lajmi dëgjuar për ndonjë aksident .

3. Në bazë të kriterit të natyrës së përmbajtjes së lëndës, që mbahet mend dallohen:

- *Kujtesa figurative (ikonografike)* i përket mbajtjes mend, rinjohjes dhe riprodhimit relativisht të saktë të figurave të atyre objekteve, që dikur janë përceptuar nga individ.
- *Kujtesa semantike (verbalo-logjike)* është kujtesë afatgjate, ku ruhen, rinjihen dhe riprodhohen të dhënat, faktet dhe raportete ndërmejt tyre, emërtimet e nocioneve dhe domethënia e tyre, rregullat, parimet dhe ligjet e proceseve dhe të dukurive të ndryshme biologjike, fizike, sociale, psikike etj.. Në kuadër të kujtesës semantike bën pjesë edhe kujtesa episodike, që ka të bëjë me të mbajturit mend dhe me riprodhimin e ngjarjeve dhe të dukurive të caktuar me fillim dhe mbarim kohor të tyre. *Kujtesa figurative, semantike dhe episodike* u emërtuan *kujtesës mentale (kujtesë intelektuale)*.
- *Kujtesa motorike* është bazë e të mësuarit të lëvizjeve, të shkathtësive dhe të shprehive të njeriut, i takon kujtesës afatgjate, ku ruhet *shpejtësia, ritmi, saktësia dhe lidhja e lëvizjeve të organeve të trupit të njeriut*.
- *Kujtesa emocionale* shfaqet me mbajtjen mend dhe me riprodhimin të disa gjendjeve emocionale të individit, të cilat individ i ka përjetuar në situata të caktuara të jetës së tij. *Kujtesa emocionale shfaqet e pandarë* nga disa forma të përmbajtjes së *kujtesës semantike dhe kujtesës figurative*. p. sh. mbajtja mend ose harresa së mbrëmjes së maturës, pikëllimi për vdekjen etj.
- *Kujtesa procedurale* nga Burton (2019) u emërtua: "*know-how?*" ("*trego si?*"). Nëse kujtesa episodike korrespondon gjerësisht me njohuritë e dorës së parë dhe kujtesën semantike me njohuritë deklaruese, atëherë *kujtesa procedurale* korrespondon me *know-how?* ose *trego si?* (Palushaj, 2020; Burton, 2019; Nushi, 2002).

Tipet e njerëzve sipas kujtesës:

- *Tipi pamor i njeriut* karakterizohet me gatishmëri të madhe për t'i marrë, mbajtur në mend dhe riprodhuar përmbajtjet e lëndëve, që ai i sheh. Shumica e nxënësve dhe i studentëve më mirë e mbajnë në mend dhe riprodhojnë përmbajtjen e lëndës, që e lexojnë sesa vetëm kur e dëgjojnë.
- *Tipi dëgjimor i njeriut* pranon, mban mend dhe riprodhon më lehtë informacione, që kanë burim dëgjimor sesa ato, që kanë burim pamor. Disa më tepër mbajnë mend kur dëgjojnë sesa kur lexojnë.
- *Tipi motorik i njeriut* është ai që mban mend dhe riprodhon lehtë përfytyrime, që mbështeten në lëvizje. Ka nxënës dhe studentë që mbajnë mend dhe riprodhojnë më lehtë përmbajtjet e lëndëve, që i shënojnë në fletore e tyre sesa vetëm i dëgjojnë dhe i shohin. (Palushaj, 2020; Nushi, 2002).

Ndryshimet e këtitilla cilësore të së mbajturit mend të përmbajtjes së lëndës shkatohen nga ndikimi, që ushtron *procesi i racioanalizimit* (mbështetet në tendencën e individit për ta qartësuar dhe për ta kuptuar më mirë të informacionin e pakutimshmën dhe të vështirë) dhe *procesi i asimilimit të lëndës të përmbajtjes së asaj, që mbahet mend dhe riprodhohet nga ana e individit të caktuar* (përshtatja e përmbajtjes së re me përmbajtjen e së vjetrës (përvojës së vejtër), që është karakteristike për anëtarët e një bashkësie të caktuar shoqërore. (Palushaj, 2020; Burton, 2019; Nushi, 2002).

4. PERCEPTIMET

Perceptimi ka të bëjë me seleksionimin e ngacmimeve, që veprojnë në shqisat tona, me organizimin e tyre në tërësi dhe dhe me dhënien kuptim këtyre tërësive. (Osmanaj, 2017; Woolfok, 2011; Spahiu, 1999). P.sh. kopshiti në oborr, automobilin, librin e ndonjë lënde etj, ne i përceptojmë si objekte të tërësive të caktuara.

Perceptimi si proces psikik i rëndësishëm dhe i ndërlikuar varet prej ndikimit të faktorëve:

- *Faktorë të jashtëm* (veçoritë e ngacmimeve, radhitjen e tyre në sende dhe objekte)
- *Faktorë të brendshëm* (personalitetin e individit, me përvojën dhe motive të tij, që i ka në kontakt me objektin).

Parimet themelore të organizimit të ngacmimeve në perceptim të bazuar në faktorë të jashtëm:

- *Parimi i afërsisë* (përceptohen si tërësi ngacmimet, që janë të afërta në hapësirë dhe kohë).

- *Parimi i ngajshmërisë* (përceptohen si tërësi ngacmimet, që janë të ngajshme).
- *Parimi i simetrisë* (përceptohen si tërësi ngacmimet e radhitura drejtë dhe në simetri).
- *Parimi i kontinuitetit* (përceptohen si tërësi unike ngacmimet e vazhdimësisë ose -----).

Parimet themelore të organizimit të ngacmimeve në perceptim bazuar në *faktorë të brendshëm*:

- *Motivi* (dëshira, nevoja ose interesi për diçka: uria, etja, lodhja, privilegji etj.).
- *Përvoja* (të mësuarit në aktivitet, të vërejturit e objekteve të ndërlikuara).
- *Gjendja emocionale* (frika, e detyron njeriun të jetë syçelë, gëzimi,).
- *Faktorë të ndryshëm shoqëror* (kultura, gjendja ekonomike, statusi, përkatësia kombëtare).

Perceptimet janë të lidhura ngushtë me *ndijimet, me të mësuarit, me kujtesën, me të menduarit, me të folurit, me ndjenjat, me motivet dhe me vullnetin e individit.*

4.1. Llojet e perceptimeve

Perceptimi i si proces psikik i ndërlikuar shfaqet në forma të ndryshme për t'u perceptuar: vizuale, akustike, motorike, aromatike, me prekje. Individët përveç se perceptojnë në forma vizuale dhe akustike, kanë nevojë edhe të perceptojnë në forma motorike duke parë dhe bërë aktivitete mësimore dhe duke hulumtuar. Rëndësi të veçantë në format e perceptimit kanë:

- *Perceptimi i hapësirës* realizohet me perceptimi vizual (shqisat e të parit), perceptimi akustik (shqisat e të dëgjuarit), perceptimi motorik (lëvizje me të prekurit dhe kinestetike: lëvizje të trupit, lëvizje e syve majtas-djathtas, lëvizje e duarve), ku çështje kryesore është thellësia e objekteve, që i perceptojmë për përcaktimin e objekteve sipas disa parametrave si gjatësisë, gjërësisë, madhësisë, pozitës dhe përvojës së individit.
- *Perceptimi i kohës* do të thotë vetëdijësim për zgjatjen kohore të një procesi apo dukurie, p.sh. te fëmija kur kryhet një aktivitet i pëlqyer kohëzgjatje i perceptohet pak, kurse për një aktivitet të papëlqyer kohëzgjatja perceptohet shumë, më mirë e kupton aktivitetin në kohën e tashme, të ardhmen dhe në fund të kaluarën, më mirë e dallon ditën e diell, kur të gjithë janë në shtëpi.
- *Perceptimi social* i individit bëhet me vëzhgimin e tij në drejtim të sjelljes së individëve të tjerë, ku vërehen cilësitë e personalitetit të tyre, ndjenjat, të motivet dhe raportet bashkëvepruese të tyre me të tjerët (krahasimin e sjelljes individuale dhe sjelljes së individëve të tjerë). Të gjithë në hapësirat, ku veprojmë reflektojmë sjellje të pëlqyeshme ose të papëlqyeshme në bazë të qëndrimit individual për vlerësimin e dukurive shoqërore ndaj respektimit të normave shoqërore.

Ndijimi është përjetimi i cilësisë së objektit, kurse perceptimi merret me tërësinë e tij. Perceptimi ndodh, kur ngacmimi është me intenzitet të caktuar, të qëndrueshëm, konstant dhe objektiv, që në vetëdijen mundëson t'i përjetojmë gjërat si një tërësi reale. Çdonjëri nga ne e përjeton tërësinë e objektit, kur ai vepron mbi shqisat tona. Ngacmimet regjistrohen në tru me ndihmën e shqisave, por përpunimi i tyre vazhdon të ndodh në tru duke shndërruar sinjalet në *ndijime* (dukuri psikike). Ndijimi si aftësi fizike dhe psikike e njeriut të shëndoshë shpreh gatishmërinë e njeriut të perceptojë objekte në botën rreth tij përmes ngacmimeve të ndryshme të vërejmë atë, që na e tërheq vëmendjen tonë ose na intereson. (Osmanaj, 2017; Spahiu, 1999:97).

Përjetimi është process psikik, që realizohet me perceptimin i formës me cilësitë veta të objektit dhe ndijimin. Objektet e ndryshme vërehen si tërësi unike, ku cilësitë e veçanta (ndijimet) shkrihen në një tërësi unike (perceptim) të objektit të caktuar, ashtu që të dy proceset në tru përjetohen si dukuri psikike .

Iluzionet ndodhin kur gjatë periudhës së perceptimit gabimisht e pasqyrojmë një objekt, që e vërejmë, e dëgjojmë ose e përjetojmë në vetëdijen tonë dhe nuk i përgjigjet realitetit.. (Spahiu, 1999:102).

Përfytyrim quhet aftësia e individit për të përtërirë në vetëdije objekte apo dukuri të perceptuara më parë, është një lloj riprodhimi i perceptimeve në bazë të kujtesës. Përfytyrimi lind pa ndikimin e ngacmuesit të jashtëm në bazat përkatëse organike dhe është i lidhur me kujtesën e individit, ku aktivizohen aftësi mendore për të rikujtuar në vetëdije të gjithë aftësitë mendore të ndodhur më parë si të perceptuarit, të ndijuarit, të kujtuarit, të menduarit për të arritur qëllimin e caktuar, kurse gjatë perceptimit nëpër shqisa vepron një lloj ngacmuesi. Përfytyrimi është më pak e gjallë, më pak e plotë dhe jo aq e qartë se sa perceptimi.

Vëmendja është aktivitet mendor në një numër të kufizuar ngacmimesh, që individi i selekcionon në momentin e duhur nga ngacmimet e shumta, që i vijnë nga jashtë. Vëmendja është drejtim i vetëdijes dhe i aktivitetit tonë në një objekt apo detyrë të caktuar. Ajo është karakteristikë e të gjithë proceseve psikike, veçanërisht intelektuale. P.sh. Ne sa herë ndiejmë nevojë për një cilësi të një objekti atë e perceptojmë, e përfytyrojmë, mendojmë për të, njihemi me të, e mbajmë mend dhe e vlerësojmë përjetimin tonë. (Spahiu, 1999:108). Faktorët që e shkaktojnë aktivitetin e vëmendjes janë:

- Faktorë të jashtëm (madhësia e ngacmimit, forca, lëvizja, ndërpreja e ngacmimit p.sh. të folurit e zëshëm, tingulli i fortë, etj.).

- Faktorë të brendshëm ose subjektivë(motivet, interesimet, shpresat, aftësitë, emocionet, qëndrimet etj.). Interesimi është faktori më i rëndësishëm, që përcakton cilësinë e të perceptuarit, të mësuarit, të menduarit dhe ndihmon vëmendja të zgjas shumë.

Vëmendja mund të shfaqet në të njëjtën kohë edhe nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm p.sh. një produkt reklamohet me mbishkrime të veçanta, por në të njëjtën kohë ngjitet një fotografi, që aktivizon motivet, interesimet, dhe dëshirat e ndryshme të njerëzve. Llojet e vëmendjes klasifikohen:

- *Vëmendja e pavullnetshme* (paqëllimshme) shkaktohet pa dëshirën e individit, pa vullnet dhe pa ndonjë qëllim në shqisat e tij nga faktorë të jashtëm
- *Vëmendja e vullnetshme* shkaktohet nga një qëllim i caktuar i faktorëve të brendshëm, që paraqesin dukuri psikike si vëmendja në: *të mësuarit, të menduarit, motivet, interesat, qëndrimet, vullnetin, dëshirat* etj.

5. EMOCIONET DHE NDJENJAT

Emocionet janë procese të veçanta psikike (shqetësime shpirtërore), që lidhen me mënyrën e reagimit të individit ndaj objektit ose dukurive të ndryshme. Emocionet paraqesin lloj përjetimi subjektiv të njeriut (gëzim, shpresë, dashuri, frikë, brengosje, hidhërim, zemërim etj.). Njeriu vlerëson veten dhe realitetin objektiv në bazë të emocioneve. Ato individit i mundësojnë të marrë qëndrim pozitiv ose negativ ndaj asaj, që është perceptuar më parë, mësuar ose është njohur më parë.

Emocionet sipas ngjarjeve të shkaktuara nga vetja ose nga të tjerë klasifikohen sipas polaritetit:

1. *Emocione pozitive –optimizmi* (ndjenja e kënaqësisë dhe sigurisë): i lumtur, i gëzuar, i kënaqur, në harmoni me vetveten dhe i suksesshëm në jetë
2. *Emocionet negative–pesimizmi* (ndjenja e pakënaqësisëdhe josigurisë): individi përjeton frikë, ankth, zhgënjim, dëshpërim, zemërimin, trishtimi, neveria e të tjera. Emocionet negative që krijojnë probleme në shëndetin mendor të individit dhe në sjelljen e tyre janë frika, ankthi, fobitë dhe zemërimi. (Krasniqi, 2016).

Llojet e ndjenjave sipas rëndësisë për jetën e njeriut:

1. *Ndjenjat primare-themelore(parësore) trashëguese janë: frika, zemërimi, gëzimi, pikëllimi.*
2. *Ndjenjat e ndërlikuara-dytësore: 1. ndjenjat shoqërore: dashuria, xhelozia, zilia, urrejtja.; 2.ndjenjat morale: sjellja e mirë dhe sjellja e keqe e individit sipas normave shoqërore dhe 3. ndjenjat estetike: vlerësimi personal i ndonjë objekti apo i ndonjë situatë si të bukur.*
3. *Ndjenjat sipas fuqisë dhe kohëzgjatjes: 1. afektet (zgjasin pak) .2. disponimet (zgjasin shumë), 3. sentimentet (ndjeshmëri): mërzia, dhembshmëria, respekti, urrejtja, patriotizmi, ndjenja për dashuri dhe miqësia dhe 4. pasioni mund të jetë pasion pozitiv (pasion për muzikë, për art, për shkencë, për letërsi) dhe pasion negativ (pasion për duhan, pasion për alkool, për narkotikë, për bixhoz etj. (Krasniqi , 2016; Spahiu, 1999:154).*

6. METODA E HULUMTIMIT

Gjatë këtij hulumtimi empiric u përdor metoda e vëzhgimit të nxënësve për të verejtur reagimet e tyre gjatë procesit së të shkruarit të esejës. Eksperimenti u zhvillua me nxënësit e klasave të VIII në shkollën fillore “Ismail Qemali” në Gostivar.

Variabël e pavaruar: Reflektimi i shkathtësive së të shkruarit të nxënësve në krijim pragmatik-ese treguese.

Variabël e varur: Strategjia e mësimdhënies me kombinim e metodave dhe teknikave të ndryshme si: kriteret e vlerësimit, stuhi mendimesh me bashkëbisedim dhe organizues grafik për rinjohje me perceptim vizuel dhe të shkruarit, prezantim, diskutim për vlerësim dhe vetëvlerësim.

7. PJESA EMPIRIKE–REALIZIMI I STATEGJISË SË MËSIMDHËNIES

Strategjia e mësimdhënies së të shkruarit të një krijimi është *procesi i ofrimit të njohurive për procesin e të shkruarit nga mësimdhënësi i tij*, nxitja e gatishmërisë së nxënësit për të shprehur qëndrim pozitiv për pranim të njohurive dhe zbatimin e tyre në procesin të krijuarit të çdo krijimi, ashtu që duke shkruar nxënësi fillon të krijojë përvojë krijuese. Gjatë përvojës sime si mësimdhënëse krijova bindjen se çdo nxënës motivohet më tepër për t’u angazhuar në procesin e mësimt, kur ai e din se çfarë kërkohet nga ia gjatë orës mësimore, që zgjat 40 minuta. Kjo njësi mësimore u realizua me platformat google.classroom dhe zoom.us , përshkak të gjendjes së pandemisë të shkaktuar nga Virusi Korona-Kovid-19. Në vijim ju ofroj një strategji për procesin të shkruarit të një krijimi të përdorur me nxënësit e klasës së VIII në Sh.F “Ismail Qemali”-Gostivar.

Lënda:Gjuhë shqipe

Tema:Kultura e të shprehurit dhe krijimtaria

Klasa: VIII

Data: 20.03.2020

Qëllimi i njësish mësimore: Kjo njësi mësimore ka për qëllim nxënësit të pranojnë njohuri për procesin e të shkruarit të një krijimi –ese treguese.

Metodat: Bashkëbisedim, monolog, demonstrim, prezantim, diskutim,

Format e punës: Punë frontale, punë e pavarur individuale,

Mjetet e punës: Power point, google-classroom.

Aktiviteti: Bashkëbisedon, shkruan, prezenton, diskuton dhe vlerëson.

Mësim on-line me platformat: Google-classroom, Zoom.us

Mësim i integruar: Gjuhë shqipe, biologji, kimi, edukim qytetar.

Realizimi i njësish mësimore :

Hapi i parë: Kriteret e vlerësimit së të shkruarit të një eseje u kumtohen nxënësve, që të gjithë nxënësit të ngazhohen në aktivitet.

- Çdonjëri t’ mundohet të shkruaj një ese!
- Çdonjëri ta shkruaj esejen sipas strukturës së saj.
- Eseja të shkruhet 15 minuta
- Esenë pasi ta shkruani: Lexojeni me zë në fillim vet! Rishikojeni edhe një herë për t’i korrigjuar gabimet! Jepjani ta lexojë dikujt, që e keni pranë! Dorëzoheni esejen!
- Prezantoheni esejen para shokëve!
- Vetëvlerësimi i esejes sipas vlerësimit të esejeve të tjera të prezantuara nga të tjerët.

Hapi i dytë: Sqarimi i konceptit ese

Eseja është krijim me shkrim kritik individual i një personi, që reflekton gjykimet individuale (mendimet për të drejtën ose të padrejtën, të mirën apo të keqen, funksionalen apo jofunksionalen, për të bukurë dhe të shëmtuarën) për ndonjë çështje shkencore, kulturore të jetës shoqërore, por të cilën krijuesi e shpreh me një ndjenjë të thellë subjektive. Eseja gjërësisht trajton çdo temë, që lidhet me jetëndhe veprimtarinë e njeriut duke i shprehur gjykimet individuale të krijuesit për çështje të caktuar, ku njeriu merret si faktor ndikues për përmirësimin dhe zgjidhjen e këtij problemi. Krijuesi eseist nisat nga një dukuri e caktuar, që në krijimin e tij e trajton, e sqaron dhe e argumenton. Eseja është krijimi më i kërkuar në veprimtarinë krijuese të sotme si në nivel lokal, rajonal dhe global, prandaj çdo njeri duhet të mësohet të shruaj ese. Dallohen dy lloje të esejeve nga pikëpamja e krijuesit: 1) *pikëpamje shkencore* (ku përdoret teori shkencore dhe 2) *pikëpamje joshkencore* (ku nuk përdoret teoria shkencore).

Esejat klasifikohen edhe sipas temës në katër lloje: *treguese, argumentuese, përshkruese, krahasimtare.*

Sqarim: Fjala “ese” është një emër në trajtën e pashquar i gjinisë femërore në rasën emërore, kurse “eseja” është një emër i gjinisë femërore në trajtën e shquar numri njëjës, por në disa raste vëreht mungesa e bashkëtingëllores “j”. Forma e fjalës “ese” :

Tabela 2. Sqarim për të shkruarit e një eseje

Forma e parë (e drejtë) sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe		Forma e dytë	
Rasat në numrin njëjës, trajta e pashquar	Rasat në njëjës, trajta e shquar	Rasat në numrin njëjës, trajta e pashquar	Rasat në numrin njëjës, trajta e shquar
E. një ese	E. eseja	E. nj ese	E. eseja
Gj. i (e) një eseje	Gj. i (e) esejes	Gj. i (e) një eseje	Gj. i (e) esesë
Dh. një eseje	Dh. esejes	Dh. një eseje	Dh. esesë
K. një ese	K. esejen	K. një ese	K. esenë
Rrj. prej një eseje.	Rrj. prej esejes.	Rrj. prej një eseje	Rrj. prej esesë

Hapi i tretë: Sqarim për strukturën, rrjedhshmërinë dhe përmbajtjen e esejes.

Tabela 3. Sqarim për të shkruarit e një eseje

Struktura e esejes	Rrjedhshmëria e të shkruarit dhe lexuarit (ortografia dhe ortoepia)	Përmbajtja
Paragrafi i parë duhet të fillojë dy rreshta më poshtë nga titulli i punimit tuaj (në pajisjet teknologjike: hapësirë 2- enter).	Krijoni fjali sipas rendit të zakonshëm (kryefjalë, kallëzues, gjymtyrë plotësuese).	Hyrja (1 paragraf).
Çdo paragraf duhet të jetë dy gishta më larg nga skajet në fletore (në pajisjet teknologjike duhet të jetë me margjina 1- inç nga të gjithë anët e formatit A-4).	Përdorni shenjat e pikësimit për të krijuar ritmin e saj (intonacionin e zërit krijohet me përdorimin e shenjave të pikësimit, pushimin e gjatë (.), pikëpresja (pushimin e shkurtër), pikëpyetje (?), pikëçuditja (!), tri pikat (....), kllapat (për sqarime)	Brendia (2-3 paragrafe).
Çdo paragraf duhet të ketë nga 5-6 rreshta.	Esejen në paragrafin e parë fillojeni me fjalën kyçe të titullit!	Përfundim (1 paragraf).

Të gjithë paragrafët të jenë me numër të njëjtë të rreshtave, që esejja të ketë strukturë të mirë.	Çdo paragraf fillojeni me kryefjalë (emër ose grup emëror), pastaj përdorni përemra, me të cilat do t'i zavendësoni emrat e përmendur më parë, që të mos përmenden disa herë, se bëhen monotone për lexuesin!	
	Në ese përdorni folje në vetën e III njëjës ose shumës.. P.sh.”Ajri është.”, “Ne jemi”, etj.!	
	Esejën në paragrafin e fundit mbarojeni me fjalën e njëjtë, që keni filluar në fillim!	

Hapi i katërt : Tema e esejës së sotme

Shënimi i titullit në dërrasë:” Të kontribuojmë për të pasur ajër të pasur në qytetin e Gostivarit”!

Sqarimi i konceptit ajër bëhet me organizues grafik- hartë semantike për sqarim të konceptit.




Figura 1. Sqarimi i konceptit ajër, përzirje e disa gazrave

Pyetjet divergjente ju ndihmojnë ta krijoni temë më lehtë, prandaj përdorni ato:

- Çfarë është ajri ?
- Cilëve qenie u nevojitet?
- Sa është i pastër ajri në qytetin e Gostivarit ?
- Çfarë ndikon në ndotjen e ajrit në Gostivar ?
- Si ta ndikojmë ne në pastrimin e ajrit ?
- Çfarë metodash ose teknikash mund të përdorim për ta pastruar ajrin në të ardhmen.

Hapi i pestë: Nxënësit u angazhuan të shkruajnë një ese për 20 minuta si detyrë shtëpie, mirëpo përshkak se duhej ta shkruani në kompjuter në Word në Times New Roman–font 12, ta rishikojnë disa herë dhe ta lëshojnë në google classroom atyre u mundësum 30 minuta. Në fakt ajo që duhej të realizohej në klasë, u realizua në shtëpi si detyrë shtëpie. Pas një 30 minutave të gjithë nxënësit përsëri u qasën në platformën zoom.us dhe i bënë prezantimet e tyre.

Hapi i gjashtë: Çdo nxënës e prezanton esejën e shkruar dhe hapet diskutim për vlerësimin e esjës më të mirë në bazë të kriterëve së të shkruarit dhe vetëvlerësimi esejës individuale. Krijim të qëndrimit pozitiv të çdo nxënësi për të kontribuar për të pasur ajër të pastër. Krijimi-ese treguese përgatitur nga Mal Zendeli klasa VIII/3 më 20.03.2020 në SHF”Ismail Qemali” në Gostivar.

**"TE KONTRIBUOJMË PËR TË PASUR AJËR TË PASTËR"
(Eko-Standard-5)**

Ajri është një përzirje gazrash së atmosferës të tokës dhe me vlerë shumë të madhe për të jetuarit e njerëzve, që përbëhet nga gazra të ndryshme si Azoti (78%), Oksigjeni (21%), Argoni(1%),Dioksidi i Karbonit (0,003%) dhe disa përbërës të tjerë, por në sasi më të vogël. Ajri është pa aromë, pa shije dhe pa ngjyrë. Ajri duhet të ruhet të mos ndotet se pa ajër nuk mund të pamedohet jeta as e njerëzve, kafshëve dhe bimëve. Ndotës kryesorë të ajrit janë njerëzit, industria dhe transporti.

Ajri ndotet më shumë nga pakujdesia e njerëzve, që i hudhin mbeturinat në çdo hapësirë të natyrës si hedhurina, që mund të ndizen nga dikush pa vetëdije duke shkaktuar zjarr e tym, që e ndot ajrin. Gjithashtu ajri ndotet shumë në stinën e dimrit edhe nga lëndët djegëse, që përdoren për në të shumicën e familjeve për t'i ngrohur objektet e tyre si dru, naftë dhe pelete. Peletet janë ndotës të ajrit dhe janë shumë të dëshmuar për shëndetin e njeriut se përbajnë një lloj ngjitëse. Të gjithë këto lëndë djegëse janë ndotës së ajrit, por janë më të lira për çdo familje.

Në qytetin e Gostivarit, për fat të keq, ajri është shumë i ndotur, për shkak të shtimit të numrit të veturave, që tani nuk pushojnë duke lëvizur në çdo rrugë të qytetit edhe nga gra edhe nga burra. Gjithashtu edhe mjetet transportuese të mallrave të ndryshëm dhe mjetet e transportit publik të njerëzve ndikojnë në ndotjen e ajrit. Fabrikat pa filtra ndikojnë shumë në ndotjen e ajrit, mirëpo tani në qytetin tonë ato shumë pak funksionojnë. Në Gostivar ndodhet deponia e mbeturinave rajonale, Rusino, të cilën këtë vit e zuri flaka dhe e ndoti ajrin shumë.

Në qytet nëse ndalohet qarkullimi i veturave brenda qytetit, me siguri njerëzit do të ecnin më tepër në këmbë dhe ajri do të ndotej më pak. Gjatë këtij muaji kjo edhe u dëshmu, masat e marra gjatë pandemisë së shkatuar nga Virusit Korona, Covid-19, të gjithë njerëzit i izoluan në karantinë nëpër shtëpitë e tyre, ashtu që veturat pushuan së lëvizuri dhe ajri filloi të pastrohet pak. Gjithashtu nëse lëndët djegëse të zavendësohen me nxehtë qendrore ajri do të ishte më i pastër. Ne jemi faktorë kryesorë, që duhet të ndikojmë në pastrimin e ajrit, por na nevojitet vetëdijësim për vlerësimin e vlerës më të çmueshme për procesin e të jetuarit të çdo gjallesë, ajri i pastër.

8. PËRFUNDIMI

Krijimi për t'u krijuar aktivizon në trurin e njeriut shumë aktivitete psikike, ashtu që çdo gjë e mbajtur mend në kujtesë, që lidhet me situatën aktuale për ta zgjidhur problemin e parashtruar aktivizon si përfytyrimin e mënyrës së perceptimit, mënyrën e të mbajturit mend, ndijimin e ndërës në atë moment, emocionet e paraqitura në atë moment kur është bërë perceptimit dhe emocionet aktuale kur shkruhet krijimi, klima pozitive krijuese me disponimi optimist për të arritur sukses në formulimin e esejes së mirë, ndjenjat estetike të së bukurës dhe nga pasioni pozitiv ndaj të shkruarit. Strategjia mësimore vlen më tepër për t'i zhvilluar shkathtësitë e të shkruarit se sa vetëm një titull në dërrasë të zezë. Qasja në mësimdhënie me strategji mësimore procedurale (metoda, teknika dhe mjete mësimore të ndryshme) i frymëzojnë nxënësit t'i qasen me vullnet, dëshirë dhe qëllim procesit së të shkruarit krijim-ese. Metodatat, teknikatat dhe mjetet e përdora në këtë strategji i frymëzuan nxënësit të bëjnë një krijim :

- Kriteret e vlerësimit e të formuluar e nxitën nxënësin me nxënie t'i qasen të gjithë aktiviteteve duke u nisur nga bashkëbisedimi, të shkruarit në mënyrë të pavarur, prezantimi, vetëvlerësimi dhe vlerësimi i esejeve.
- Sqarimet e dhëna nga mësimdhënësi për procesin e të shkruarit u pranuan me vullnet nga nxënësit.
- Perceptimi vizuel në organzues grafik i nxiti nxënësit në bashkëbisedim për të shprehur "stuhi idesh" lehtësoi procesin e të menduarit kritik dhe krijues të tyre me riaktivizimin e kujtesës për zgjidhjen e problemit ose formulimi i krijimit – ese treguese sipas temës pragmatike së caktuar.
- Parashtrimi i pyetjeve divergjente e nxiti të menduarit kritik dhe krijues të nxënësit për të bërë zgjidhje të problemit.
- Përfytyrimi i ambientit të ndotur në qytetin e Gostivarit u paraqitet nxënësve nga perceptimet vizuale të mjedisit, ku ata jetojnë dhe nuhatja e aromës helmuese, që paraqitet në Gostivar, kur hedhurinat ndizen në deponinë Rusino.
- Pesimizmi i shfaqur te nxënësit nga situata e pandemisë së virusit Korona, Kovid-19 është rikthyer në optimizëm për të krijuar ese-pragmatike si mundësi për t'i shprehur përjetimet emocionale të zemërimit të shfaqura nga situata aktuale.
- Dëshira e nxënësve për të pasur ajër të pastër i nxit të mendojnë për të ecur më tepër në këmbë se sa me vetura.
- Vullneti i nxënësve për të shkruar krijim me vlerë individuale dhe shoqërore.

Reagimet e nxënësve për realizimin e esejes:

- Pjesëmarrje në bashkëbisedim për plotësimin e organizuesit grafik me shprehje të ideve.
- Vullnet për t'u qasur procesit së të shkruarit të krijimit-ese.
- Reflektim të përvetësimit të njohurive për të shkruarit e esejes të dhëna nga mësimdhënësi.
- Reflektim të shkathhtësive së të shkruarit të esejes sipas strukture, kronologjisë dhe respektimit të ortografisë.
- Reflektim të shkathhtësive të prezantimit.
- Reflektim të shkathhtësive të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të esejeve të të tjerëve.
- Reflektim të shkathhtësive për përdorimin e teknologjisë dixhitale.

Në bazë të gjithë të dhënave teorike për qasjen në mësimdhënies për procesin e të shkruarit të një krijimi u zbatua një njësi mësimore on-line me ndihmën e e strategjisë mësimore për të shkruarit me platformat google.classroom dhe zoom.us. Mirëpo sikur të ishim në klasë më mirë do të vërehej angazhimi i çdo nxënësi në procesin e të shkruarit. Çdo përvojë mësimore mund të shndërrohet edhe në teori mësimore.

REFERENCAT

- Doyle, A. (2019). Creative Thinking Definition, Skills, and Examples parë më 10 shkurt 2018 në: <https://www.thebalancecareers.com/creative-thinking-definition-with-examples-2063744>
- Doyle, A. (2020). Critical Thinking Definition, Skills, and Examples parë më 26.09.2020 <https://www.thoughtco.com/critical-thinking-definition-with-examples-2063745>
- Burton, N. (2019). The Psychology and Philosophy of Memory, And 10 ways to improve your memory Article updated on 18 June 2019, parë më 09.02.2020:
- Graham, S. (2019)-Approaches to process writing parë më 01.02.2020 në: <https://www.teachingenglish.org.uk/article/approaches-process-writing>
- Krasniqi, N. (2016). Analiza e pjekurisë emocionale të nxënësve adoleshentë të shkollave të mesme të Republikës së Kosovës si indikatorë për arritjen e suksesit në mësim parë më 30.04.2020 në: https://uet.edu.al/images/doktoratura/Nerxhivane_Krasniqi.pdf
- Musai, B. (2014). Metodologji e mësimdhënies –Arti dhe shkenca të përgatitur nga nxënës të suskeshëm, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Botimi i dytë ISBN: 978-99927-822-2-6, Tiranë.
- Musai, B. (2009). Si të shkruajmë ese, CDE (QAD), ISBN 999-27-994-1-2, Tiranë.
- Musai, B. (2004). Si të shkruajmë një punim shkencor, Qendra për Arsim Demokratik(CDE), Tiranë .

- Musai, B. (2005). Mësimdhënia dhe të nxënësit ndërveprues-Modele për zhvillimin e të menduarit kritike të nxënësve
- Nushi, P. (2002). Psikologjia e përgjithshme I, Libri shkollor, Prishtinë Fq.190.
- Osmanaj, M. (2017). parë më 22.09.2020 në:
<https://edukimi.uni-gjk.org/upload/dokumentet/66852-Margarita%20Osmanaj.pdf>
- Palushaj, R. (2020). Psikologji e përgjithshme, parë më 23.09.2120 në:
https://www.academia.edu/24907074/Psikologji_e_pergjithshme
- Woolfok, A. (2011). Educational Psychology, Eleventh edition, PEARSON, 2010 ose shqip: Psikologji edukimi, Universiteti Shtetëror i Ohajës, botuar nga QAD (CDE) ISBN:978-99956-726-7-6, Tiranë, 2011.
- Spahiu, S. (1999). Psikologjia-Libri Shkollor,Këshilli Mësimor i SHLP-së në Prishtinë më 19.08.1990.
- Zajazi, T. (2003). metodologji e mësimdhënies dhe nxënies,Vinsent Graphic,Shkup Fq.190
<https://www.psychologytoday.com/us/blog/hide-and-peek/201806/the-psychology-and-philosophy-memory>
- Edith Cowan University (2018) Centre for Learning and Teaching parë më 01.02.2020 në:
https://intranet.ecu.edu.au/_data/assets/pdf_file/0004/772249/creative-thinking.pdf
- Left and Right Hemisphere of të brain*, Octomber 29, 2019 parë më 29.04.2020 në:
<https://human-memory.net/left-and-right-hemisphere-of-the-brain/>